



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63, nenin 64.2, nenin 113.4 të Ligjit Nr.03/L-073, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, bazuar në vendimin e Presidentes të Republikës së Kosovës të datës 10.12.2022, Nr.09/1637/2022, për shtyrjen dhe caktimin e datës së re të zgjedhjeve të jashtëzakonshme për Kryetar të Komunave: Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok, si dhe zgjedhjeve të parakohshme për kuvendet e komunave: Zveçan dhe Leposaviq, si dhe vendimin për miratimin e rishikimit të Planit të buxhetit për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar të Komunave: Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok, si dhe zgjedhjet e parakohshme për kuvendet e komunave: Zveçan dhe Leposaviq, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datë 23.04.2023, merr këtë:

V E N D I M

Për Pagesat e Stafit të Angazhuar në Qendrat e Votimit (QV) dhe në Vendvotime (VV)

- I. Miratohen pagesat stafit të angazhuar në Qendrat e Votimit (QV) dhe në Vendvotime (VV), për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar të Komunave: Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok, si dhe zgjedhjet e parakohshme për kuvendet e komunave: Zveçan dhe Leposaviq, që do të mbahën më 23 prill 2023, si në vijim:
1. Njëzet e gjashtë EURO e pesëdhjetë cent (26.50) € në ditë çdo Menaxheri të Qendrës së Votimit. Menaxherët e Qendrave të Votimit, do të paguhën për periudhën kohore prej tri (3) ditësh;
 2. Dyzet e pesë EURO (45.00) € në ditë, çdo Kryesuesi të Këshillit të Vendvotimit. Kryesuesit e Këshillit të Vendvotimit, do të paguhën për periudhën kohore prej tri (3) ditësh;
 3. Tridhjetë EURO (30) € në ditë, çdo Anëtari të Këshilli të Vendvotimit. Anëtarët e Këshillave të Vendvotimit, do të paguhën për periudhën kohore prej tri (3) ditësh;
 4. Tetëmbëdhjetë EURO (18) € në ditë, çdo Zyrtari të Tavolinës Ndhimese në Qendër të Votimit. Zyrtarët e Tavolinës Ndhimese, do të paguhën për periudhën kohore prej dy (2) ditësh;

5. Gjashtëmbëdhjetë EURO (16) € në ditë, çdo Asistenti në Qendër të Votimit. Asistentët e QV-ve, do të paguhën për periudhën kohore prej dy (2) ditësh;
 6. Njëzet e dy EURO e pesëdhjetë cent (22.50) € në ditë, çdo Anëtari Rezervë të Këshillit të Vendvotimit në Qendër të Votimit. Anëtarët Rezervë të KVV-ve, do të paguhën për periudhën kohore prej dy (2) ditësh;
 7. Pesëdhjetë EURO e pesëdhjetë cent (50.50) € në ditë, çdo Pronari të Kombibusit për transportimin e materialit jo të ndjeshëm dhe të ndjeshëm zgjedhor. Pronaret e kombibusëve, do të paguhën për periudhën kohore prej dy (2) ditësh;
 8. Pesëmbëdhjetë EURO (15) € në ditë, do të paguhet, çdo Punëtor Fizik për ngarkimin dhe shkarkimin e materialeve zgjedhore në KKZ.
- II. Pagesat për të gjitha kategoritë e sipër përmendura janë llogaritur në Bruto.
- III. Obligohen Zyrtarët e Lartë Komunal të Zgjedhjeve dhe anëtarët e KKZ-ve, që brenda pesë (5) ditëve, pas ditës së zgjedhjeve (23.04.2023) t'i dorëzojnë listat e pagesave me saktësi në formë fizike (*të nënshkruar*) dhe elektronike, në Sekretariatit e KQZ-së.
- IV. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, për zbatimin e këtij vendimi.
- V. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 23.04.2023

Kryesues
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve


Kreshnik Radoniqi

